

ACHIEVING SUSTAINABILITY THROUGH AN INTEGRATED APPROACH TO THE MANAGEMENT OF CULTURAL HERITAGE



SUSTCULT
Ne bëjmë
ndryshim në
menaxhimin e
Trashëgimisë
Kulturore

CONTENT

Fjala.....	1
Zoom - Qyteti I Bacau-t dhe Hurezi-t Manastiri.....	2
Të rejat nga projekti.....	3
SUSTCULT Rrjeti transnacional.....	4

SUSTCULT LETËR INFORMATIVE ÇESHTJA # 4 - Maj 2013

Fjala nga Kryetari i Bacau-t, Z. Romeo Stavarache



Është kënaqësi e madhe për mua të përshëndes këtë iniciativë dhe në të njëjtën kohë edhe sfidën që paraqet projekti Sustcult: hartimin e Planit të Menaxhimit për trashëgiminë kulturore për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm në Europën Juglindore. Bashkia e Bacău-t uron Agjensinë e Zhvillimit Lokal për përpjekjet dhe përfshirjen në një projekt të tillë nga i cili do të përfitojë gjithë komuniteti i Bacău-t.

Trashëgimia kulturore e Bacău-t nuk është jashtëzakonisht e pasur, por ajo përbën një aset të domosdoshëm të kujtesës së përbashkët të qytetarëve tanë.

Kështu, ne vazhdimisht kujtojmë se duke poseduar trashëgimi të tillë kulturore dhe historike, vihemi në detyrime të caktuara të cilat gjithashtu kërkojnë përbushjen e angazhimeve të caktuara

Është detyra jonë të ruajmë mbetjet kulturore dhe të sigurojmë që këto të kalojnë te brezat e ardhshëm, duke l ruajtur dhe mbrojtur ato përmes mënyrave specifike. Në nivel lokal, Ansambli Gjyqësor ka një kontribut të rëndësishëm mbi njohuritë dhe të kuptuarit e historisë dhe zhvillimit të komunitetit tonë, kjo është arsyeja pse unë duhet të shpreh vlerësimin tim të sinqertë për punën që është kryer për hartimin e Planit të Menaxhimit.

Një dokument i tillë asnjëherë nuk është zhvilluar deri më tani për këtë monument historik dhe është përfitim për komunitetin tonë të ketë një plan që ekspozon vlerat, çështjet, presionet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore si dhe strategjitë dhe mekanizmat që kanë për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, konservimin dhe mobilizimin e trashëgimisë për zhvillimin brenda një pikëpamjeje që arrin përtej fitimeve të shkurtra ekonomike, drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Unë do të doja të përfitoj nga ky rast për të mirëpritur partnerët e SUSTCULT në Bacău, të falënderoj ata për gjithë mbështetjen që dhanë për ekipin tonë dhe t'i uroj atyre sukses në aktivitetet e ardhshme. KRYETARI,
Romeo Stavarache

Fjala nga Kryetari i Horezi-t, Z. Ilie Fartat

Pjesëmarrja si aktor në projektin Sustcult ka shkaktuar një dialog interesant dhe shumë aktiv i cili do të çojë në planin e zhvillimit për mbrojtjen dhe menaxhimin e Manastirit të Horezi-t, një objektivi i UNESCO-s i cili është veçanërisht i rëndësishëm për Qarkun e Valcea-s dhe gjithë Rumaninë. Autoritetet lokale mbështesin projektin sepse një objektivi i tillë nxjerr në pah Valcea-n dhe thesarin e trashëgimisë kulturore, i cili do të risë numrin e vizitorëve në vend dhe zhvillimin e qëndrueshëm për këtë rajon.

Fakti që ka dy element të trashëgimisë kulturore në Horezi të listuara në UNESCO, Trashëgimia e qeramikës së Horezi-t si trashëgimi e paprekshme, dhe Manastiri i Horezi-t si trashëgimi e paluajtshme e bëjnë këtë zonë një destinacion unik në Rumanë. Ju presim në Horezi të shihni traditën dhe spiritualitetin e këtyre vendeve
KRYETARI,
Ilie Fartat



ZOOM – QYTETI I BACAU-T, RUMANI

Localizuar në anën lindore të Rumanisë, Qyteti i Bacau-t ndodhet në Rajonin e Moldavisë dhe shtrihet në pellgun e mesëm të lumit Siret, në rrjedhën e poshtme të lumit Bistrita dhe në pellgun lumor Trotus.

Ansambli i Gjykatës Princërore është simbol i spiritualitetit dhe kulturës për gjithë rajonin dhe është i lokalizuar në anën lindore të Bashkisë së Bacau-t. Ansambli i Gjykatës Princërore përfshin Kishën "Virgjëresha" - "Fjetja e Shen Mërisë", rrënojat e Gjykatës Princërore dhe rrënojat e Kullës.

Plan i Menaxhimit të Ansambllit të Gjykatës Princërore



Bashkisë Bakau. Në procesin e hartimit të këtij Plani, kontributi i madh i aktorëve vendor është pasqyruar nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre dhe përfshirjes në takimet e punës në kuadër të projektit, duke siguruar informacion dhe rezultate për çdo hap të ndërmarrë.

Deri tani, grupi mbështetës lokal ka identifikuar problemet kryesore dhe çështjet që duhet të trajtohen nga Plani i Menaxhimit, pra formësimin e vizionit dhe drejtimet kryesore të

për Bacau-n, i zhvilluar nëpërmjet projektit SUSTCULT, nënvizon vizionin dhe objektivat strategjike për zhvillimin e këtij siti të trashëgimisë i cili është shumë i rëndësishëm për kulturën dhe identitetin e



zhvillimit. Prandaj, Ansambli i Gjykatës Princërore do përfaqësojë një pikë kryesore për kulturën e komunitetit lokal dhe turizmin kulturor në Bashkinë e Bacau-t duke kapitalizuar elementet specifike dhe zhvillimin urban të rajonit. Plani i Menaxhimit do të detajojë mjetet e përbushjes së këtij vizioni, dokumentat adresuar gjithë komunitetit lokal, duke përfshirë institucionet dhe administratën publike, komunitetin e biznesmenëve, organizatat jo-qeveritare, po ashtu dhe qytetarët e Bashkisë së Bacau-t

ZOOM – MANASTIRI I HOREZI-T

Manastiri i Horezi-t është një nga kryeveprat më të rëndësishme dhe autentike të arkitekturës Rumune, unike në artin post-Byzantine Ballkanik. U përfshi në listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 1993. Manastiri u dizenua dhe u ndërtua nga Princi Constantin Brâncoveanu (1688-1714). I edukuar në Mendjen Lindore, dinastia e Prince Basarab, është konsideruar pasardhës dhe trashëgimtar i aristokracisë Bizantine Ai dhe familja e tij themeluan disa kisha me mure të stilit Bizantin me dekorime të kushtueshme spektakolare.

Këto vepra artistike kanë frymëzuar pronarë të tjerë dhe më vonë çuan në formimin e stilit Brancovan, një sintezë e artit Lindor Bizantin dhe artit Perëndimor, veçanërisht Venecian. Kompleksi i Manastirit të Horezi-t është kompleksi më i madh i manastirit në Rumania dhe është konsideruar si kryevepër e stilit Brancovan: Është e njohur për pastërtinë arkitekturore dhe balancën, pasurinë e detajeve skulpturore, trajtimin e kompozimeve



atyshëm, 5 km larg, është e lidhur me manastirin. Dokumentari

fetare, portretet kushtuar dhe punëve dekoruese murale.

Manastiri i Horezi-t është lokalizuar në një zonë pikturuese në këmbët e Karpateve në pjesën veriore të Oltenia-s Historia e Horezi-t, qytetit të

i parë përmendës i Horezi-t është akti i 5 Shtatorit, 1487 në mbretërimin e Murgut Vlad (1482-1495), i cili përmend zgjidhjen e shqiponjës-buf, një emër që vjen nga një zog grabitqar, i zakonshëm për këtë zonë. Qyteti është i famshëm për zejen e qeramikës. Teknika dekoruese, ngjyra, kompozimet janë arsye të veçanta që justifikojnë përfshirjen e kësaj trashëgimie në listën e trashëgimisë së paprekshme të UNESCO-s në vitin 2012. Çdo vit në Qershor, Horezi organizon një festival dedikuar qeramikës të quajtur Gjeli i Horezi-t me poçar nga i gjithë vendi.

Në kuadër të projektit SUSTCULT dhe nën koordinimin e qytetit të Venecias, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë së bashku me Komitetin Këshillues dhe komunitetin lokal është duke zhvilluar Planin e Menaxhimit të Horezi-t. Plani është projektuar për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm në kontekstin e gjithë rekomandimeve të UNESCO-s për mbrojtjen e manastirit dhe trashëgimisë botërore. Proçesi i restaurimit, ruajtjes dhe rehabilitimit të Manastirit të Horezit është në progres pas një plani ndërhyrës të vitit 2010 duke përmirësuar planin e pajtueshmërisë i cili nxjerr në pah vlerat universale të Manastirit.

Manastiri i Horezi-t është sot një nga atraksionet më të rëndësishme turistike në Rumania, është konsideruar si qendër e spiritualitetit në jug të Karpateve.



TE REJAT NGA PROJEKTI

Prezantimi zyrtar i Planit të Menaxhimit për sitin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s "Venecia dhe Laguna e saj"

Në 22 Mars 2013, Plani i Menaxhimit të sitit të trashëgimisë botërore të UNESCO-s "Venecia dhe Laguna e saj" u prezantua zyrtarisht në Venecia në prezencë të Kryetarit të Venecias Giorgio Orsoni, Drejtorit për zyrën Rajonale të Shkencës dhe Kulturës në Europë (Venecia) Z. Yolanda Valle-Neff, dhe aktorëve kryesorë të sitit. Takimi ishte një rast i rëndësishëm për t'i prezantuar publikut dhe aktorëve rezultatet e punës sfiduese të institucioneve të shumta dhe praktikantëve që morrën pjesë në përgatitjen e Planit të Menaxhimit. Plan i vërtetë është rezultat i një procesi të gjatë dhe kompleks të konsultimit dhe koordinimit mes autoriteteve lokale, aktorëve dhe komunitetit



lokal. Vëmendje e veçantë i është dhënë burimeve për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sitit dhe çështjeve kryesore që kanë për tu përballur në vitet e ardhshme për të mbrojtur karakteristikat unike të lagunës që lejojnë në përfshirjen në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në 1987. Takimi ishte gjithashtu një rast i mirë për të përfshirë direkte institucionet lokale të cilat janë aktive në sit dhe të prezantojnë progresin e projektit European SUSTCULT i cili synon të përmirësojë efektivitetin e sive të trashëgimisë në të gjithë rajonin e EJL (Europa Jug-lindore).

Video e re e SUSCTULT online

Video e projektit SUSTCULT është realizuar në Mars 2013 dhe i është prezantuar në Venecia të gjithë partnerëve dhe aktorëve. Video synon shpërndarjen me imazhe dhe fjalë të koncepteve kryesore dhe sfidat e projektit; ajo përqëndrohet në angazhimin e projektit për një qasje të integruar në menaxhimin e trashëgimisë kulturore në rajonin e EJL-së

Video e re e SUSTCULT është në YOUTUBE dhe VIMEO! Prodhuar nga Tuna Studio në bashkëpunim me Qytetin e Venecias.

<http://www.youtube.com/watch?v=DOKd5MWhSao>

<http://vimeo.com/62930277>



Paketa e Punës (PP) 7 – Stimulimi i punës dhe gjenerimit të të ardhurave nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.

Atraksionet kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në tërheqjen e një numri të madh të turistëve në të gjitha nivelet dhe për këtë arsye veprojnë si katalizatorë të zhvillimit ekonomik.

Nëse ky zhvillim është vërtetë i qëndrueshëm, me ndikime afatgjata ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit, kjo varet nga faktet nëse trashëgimia kulturore promovohet dhe menaxhohet në një mënyrë të koordinuar dhe të integruar. PP7 filloi në 2013, duke parashikuar të:

- identifikojë potencialin dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik të trashëgimisë kulturore në të gjithë zonën e EJL-së;
- identifikojë potencialin dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik duke ngritur strategjinë e marketingut dhe planin e biznesit për burime specifike të siveve të trashëgimisë së SUSTCULTI;
- të propozojë udhëzime (piketa) bazuar në parimet e qëndrueshmërisë se si të promovojë sitet e trashëgimisë kulturore të EJL, edhe nga një këndvështrim rajonal ose transnacional.

Java ndërkombëtare në mbështetjen e Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Rishikimi i Takimit afatmesëm në Korfuz - Tetor 2012

Nga 1-5 Tetor 2012 partnerët e SUSTCULT u takuan në Korfuz në Javën Ndërkombëtare të Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore që u organizua nga CulturePolis nën kujdesin e Bashkisë së Korfuzit dhe në mbështetjen e Rajonit të Ishujve Jonian. Specialist i Programit nga zyra e UNESCO-s në Venecia, Z. Philippe Pypaert, Experti i trajnimit të siteve të SUSTCULT, Z. Jukka Jokilehto dhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës gjithashtu pritën këtë event. Gjatë javës ndërkombëtare mbi 15 pjesmarrës të përzgjedhur morrën pjesë në Workshopin 3-ditor të Trainimit në Sit, ndërsa 10 të tjerë panë sesionin hyrës i cili u transmetua



Ishujve të tjerë Jonian nëpërmjet sistemit të telekonferencës. Përveç kësaj, më shumë se 80 persona morrën pjesë në Eventin informues, ku u prezantuan rezultatet e para të projektit SUSTCULT, si dhe aplikimi i Metodologjisë në Qytetin e Vjetër të Korfuzit; u mbledh edhe një tavolinë e rrumbullakët me


përfaqësues nga tre grupet kryesore nga "Komiteti Konsultativ SUSTCULT Korfuz/Qyteti i Vjetër". Java ndërkombëtare përfshiu gjithashtu një konferencë për shtyp, rishikimin e takimit afatmesëm, një takim me ekspertët e Web-Gis, si dhe mbledhjen e Partnerëve dhe takimin e Komitetit Drejtues të cilat ishin njëloj produktive dhe prodhuan diskutime efektive, ndarjen e eksperiencave dhe marrëveshjen mbi hapat e ardhshëm të implementimit të projektit.



Rrjeti Ndërkombëtar në LinkedIn

Objektivi kryesor i Rrjetit Ndërkombëtar të SUSTCULT është të themelojë një rrjet ndërkombëtar afatgjatë në E.J.L të organizatave, organeve publike, bizneseve dhe aktorëve lokal në fushën e promovimit dhe ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore. Rrjeti do të veprojë si katalizator ndërkombëtar për ndarjen e njohurive dhe bashkëpunimin nëpërmjet një hapsire për punë ineraktive për aktorët dhe praktikantët e trashëgimisë në E.J.L. Ndiqni projektin dhe aktivitetet e rrjetit në LinkedIn.

<http://www.linkedin.com/groups/SUSTCULT-Transnational-Network-4959132/about>



PARTNERI LIDER

Qyteti i Venecias - Politikat Europiane dhe Departamenti i Planifikimit Urban - S. Marco 4299, 30124 Venice, Italy.

european.policies@comune.venezia.it; <http://www.sustcult.eu/>